



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES

Nr. 653/prot.
5

Tiranë, më 13.10.2025

VENDIM
Nr. 40, datë 13.10.2025

PËR
PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VERIFIKIMIT TË EKZEKUTIMIT TË
VENDIMIT TË KOMISIONERIT NR. 42, DATË 16.7.2024

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenet 11, pika 1 dhe 14, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe Rregulloren, "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, (e ndryshuar), pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorit të Përgjithshëm të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes dhe Drejtorit për Zbatimin e Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit, në lidhje me verifikimin e zbatimit të Vendimit nr. 42, datë 16.7.2024, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Kurbini dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës",

KONSTATOVA SE:

Me Urdhrin nr. 42, datë 21.3.2024, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimin të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, si dhe gjatë aplikimit të institutit të disiplinës në shërbimin civil, në Bashkinë Kurbini", Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, në institucionin Bashkia Kurbini.

Ky proces është përmbyllur me Vendimin nr. 42, datë 16.7.2024, të Komisionerit, "Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin e Bashkisë Kurbini dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës", të Komisionerit, ku janë lënë detyra konkrete për rregullimin e ligjshmërisë.

Me kalimin e afatit të lënë në vendimin e mësipërm, me Urdhrin nr. 65, datë 2.7.2025, "Për kryerjen e mbikëqyrjes në vazhdim në lidhje me zbatimin e vendimit paralajmërues nr. 42, datë 16.7.2025, të Komisionerit", Komisioneri ka urdhëruar fillimin e mbikëqyrjes në vazhdim për zbatimin e vendimit paralajmërues nr.42, datë 16.7.2024, në institucionin Bashkia Kurbin, sipas drejtimeve të programit të mbikëqyrjes në vazhdim nr.655/1, datë 02.07.2025, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar Kryetarit të Bashkisë Kurbin me shkresën nr.655/2, datë 2.7.2025, "Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të vendimit nr. 42, datë 16.7.2025 të Komisionerit". Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes, ku verifikoi situatën dhe administroi dokumentacionin e njehsuar që materializon veprimet administrative të kryera në zbatim të vendimit paralajmërues.

Mbështetur në detyrat e lëna në Vendimin nr.42, datë 16.7.2024, si dhe referuar informacionit të administruar në subjekt, vërej se situata e administrimit të shërbimit civil në institucionin e mbikëqyrur paraqitet si më poshtë vijon:

Në **pikën 2**, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil, marrjen e masave për të siguruar klasifikimin racional të pozicioneve të punës në përputhje me ligjin dhe udhëzimet përkatëse, si në vendimin paralajmërues ashtu edhe në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.

Konstatohet se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore, pranë Bashkisë Kurbin ka përcaktuar grupin e punës përgjegjës për mbledhjen dhe analizimin e informacionit mbi pozicionet e punës në strukturën aktuale të shërbimit civil, i cili, në përfundim të këtij procesi, rezultatet e analizës, që përfshijnë përcaktimin e detyrave, përgjegjësi, nivelit të arsimit, fushës së studimeve dhe përvojës në punë për secilin pozicion, i ka pasqyruar në një raport përmbledhës. Me aktin nr. 3695/1 prot., datë 8.8.2024, ky raport i është dërguar të gjithë njësive përbërëse të institucionit, me qëllim hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës.

Në vijim, me shkresën nr. 3695/2 prot., datë 20.8.2024, Drejtoria e Burimeve Njerëzore i ka përcjellë Komitetit të Vlerësimit dhe Klasifikimit të Pozicioneve të Shërbimit Civil dokumentacionin përkatës, të nevojshëm për kryerjen e procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës, në përputhje me përcaktimet e kreut V, të vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe kërkesat e vendimit paralajmërues të Komisionerit.

Më tej, me shkresën nr. 3695/3 prot., datë 21.08.2024, grupi i punës ka konfirmuar marrjen e dokumentacionit të përcjellë përmes shkresës nr. 3695/2 prot., datë 20.08.2024, duke formalizuar kështu nisjen e procedurës së vlerësimit dhe klasifikimit të pozicioneve të punës, në përputhje me përcaktimet ligjore.

Sipas përcaktimeve të nenit 29/ç, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e

administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, me urdhrin nr. 135/1, datë 22.8.2024, vërej se është ngritur Komitetit i Vlerësimit dhe Klasifikimit të pozicioneve të punës të Shërbimit Civil, si strukturë përgjegjëse për administrimin e procesit të vlerësimit.

Nëpërmjet shkresës nr. 5539 prot., datë 7.11.2024, Komiteti i Vlerësimit dhe Klasifikimit të pozicioneve të punës të Shërbimit Civil ka hartuar një listë përmbledhëse, ku janë pasqyruar pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, të klasifikuara në kategorinë dhe klasën përkatëse sipas klasave të zbatueshme për secilën kategori të përcaktuara në nenin 19, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Njëkohësisht, Komiteti i Vlerësimit dhe Klasifikimit, pasi administroi dokumentacionin e nevojshëm të përcjellë nga njësia e burimeve njerëzore, ka zbatuar detyrimin për identifikimin e saktë të pozicioneve të punës që do t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit. Më tej, Komiteti ka vijuar me procesin e vlerësimit të këtyre pozicioneve, duke u mbështetur në përshkrimet përkatëse të punës dhe në metodologjinë zyrtare të vlerësimit të pozicioneve të punës, e materializuar në aktin nr. 4076 prot., datë 29.8.2024, në zbatim të lidhjes nr. 5, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.

Në përfundim të këtij procesi, konstatohet se është hartuar dhe miratuar plani i rekrutimeve në shërbimin civil me aktin nr. 4076/2 prot., datë 30.8.2024.

Në **pikën 3**, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Kurbini të konstatohet pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit të nxjerra në kundërshtim me ligjin për 28 punonjësit e emëruar në pozicione pune të shërbimit civil të kategorisë ekzekutive.

Nga analiza e të dhënave të administruara vërej se për pozicionet e punës që i përkasin kategorisë ekzekutive, nga ana e njësive përgjegjëse janë kryer disa veprime administrative për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil. Konkretisht, rezultojnë se janë shpallur (*shpalljet e vendeve vakante nr. 4471 prot., datë 23.9.2024, nr.4612 prot., datë 30.9.2024, nr. 4610 prot., datë 30.9.2024, nr. 4611 prot., datë 30.9.2024, nr.4994 prot., datë 15.10.2024, 4436 prot., datë 19.9.2024, nr. 4609 prot., datë 30.9.2024, 4472 prot., datë 23.9.2024*) dhe më tej janë kryer procedurat e konkurrimit për plotësimin e disa pozicioneve vakante, në përfundim të të cilave kanë rezultuar fitues dhe janë emëruar nëpunësit si më poshtë:

1. Jurison Hasa, emëruar në pozicionin “*Specialist i Emergjencave Civile*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, me aktin nr. nr.4887/2 Prot, datë 29.10.2024;
2. Florinda Gjeçi, emëruar në pozicionin “*Specialist Kontabiliteti*”, në Drejtorinë e Financës, me aktin nr. 4886/2, datë 29.10.2024 (673/1 prot.);
3. Erisjola Zambaku, emëruar në pozicionin “*Specialist Buxheti*”, në Drejtorinë e Financës, me aktin nr. 4885/2, datë 29.10.2024;

4. Ndriçim Mema emëruar në pozicionin “*Specialist i Emergjencave Civile*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, me aktin nr. nr.4889/2 Prot, datë 29.10.2024;
5. Anselma Prenga, emëruar në pozicionin “*Specialist Kadastre*”, në Njësinë Administrative Mamurras, me aktin nr.4998/2 datë 1.11.2024;
6. Jonida Merlika, emëruar në pozicionin “*Specialist Inxhinier Ndërtimi, Sektori i Planifikimit Territorit*”, në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, me aktin nr. 4996/2, datë 01.2024;
7. Ermira Kodra, emëruar në pozicionin “*Specialist për Monitorimin e Tregut dhe Mbrojtjes së Konsumatorit*”, në Drejtorinë e Mjedisit, me aktin nr. 4997/2, datë 1.11.2024;
8. Fabjan Rrema, emëruar në pozicionin “*Specialist IT dhe Koordinator për të Drejtën e Informimit*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, me aktin nr. 5297/2, datë 14.11.2024;
9. Laudersa Bardhi, emëruar në pozicionin “*Specialist IT*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, me aktin nr. 5298/2, datë 14.11.2024;
10. Sara Çuni, emëruar në pozicionin “*Specialist Topograf, Sektori Teknik dhe GIS*”, në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, me aktin nr. 5299/2, datë 14.11.2024;
11. Irdisa Bushi, emëruar në pozicionin “*Koordinator i Dhunës në Familje, Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve, Barazisë Gjinore dhe Shëndetësisë*”, në Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike dhe Kujdesit Social, me aktin nr. 4778/2, datë 25.10.2024;
12. Silvia Laska, emëruar në pozicionin, “*Specialist Veteriner*”, në Drejtorinë e Mjedisit, me aktin nr. 4609/9, datë 1.11.2024;
13. Regjina Tusha, emëruar në pozicionin “*Specialist për Strehimin*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, me aktin nr. 4882/2, datë 29.10.2024;
14. Sara Fufi, emëruar në pozicionin “*Specialist për Strehimin*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, me aktin nr. 4878/2, datë 29.10.2024;
15. Eristigena Gega, emëruar në pozicionin “*Specialist Jurist, Sektori Juridik*”, në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve Publike, me aktin nr. 4880/2, datë 29.10.2024;
16. Marind Lleshi, emëruar në pozicionin “*Specialist i Arkivës*”, në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit, me aktin nr. 4879/2, datë 29.10.2024;
17. Marinela Markaj, emëruar në pozicionin, “*Specialist Jurist*”, në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve Publike, me aktin nr. 4881/2, datë 29.10.2024.
18. Daniela Gjergji, emëruar në pozicionin “*Specialist për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve*”, në Njësinë Administrative Fushë Kuqe, me aktin nr.4776/2 Prot, datë 25.10.2024.

Përveç procedurave të mësipërme, konstatoj se njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë Bashkisë Kurbin, ka shpallur procedurat për rekrutim në shërbimin civil 9 për pozicionet e mëposhtme:

1. “*Specialist për Taksën Familjare dhe Taksën e Tokës*”, në Drejtorinë e Planifikimit të të Ardhurave, me shkresën 3169 prot., datë 10.7.2025;

2. “*Specialist Buxheti*”, në Drejtorinë e Financës, me shkresën nr.3133 prot., datë 7.7.2025;
3. “*Specialist i Kujdesit Social, Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Shëndetësisë, Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve, Barazisë Gjinore dhe Shëndetësisë*”, në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Kujdesit Social, me shkresën nr.3184 prot., datë 10.7.2025;
4. “*Specialist i Emergjencave Civile*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, me shkresën nr.3132 prot., datë 7.7.2025;
5. “*Specialist i Burimeve Njerëzore*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, me shkresën nr. 3185 prot., datë 10.7.2025;
6. “*Specialist Kontabiliteti*”, dhe “*Specialist i Emergjencave Civile*”, në Drejtorinë e Financës, me shkresën nr. 3414 prot., datë 22.7.2025;
7. “*Specialist i Emergjencave Civile*” në Drejtorinë e Financës, me shkresën nr.3414 prot., datë 22.7.2025;
8. “*Administrator i Ndhmës Ekonomike*” dhe “*Administrator*”, në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike, me shkresën nr. 3133 prot., datë 7.7.2025;
9. “*Administrator*”, në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike, me shkresën nr. 3133 prot., datë 7.7.2025;

Ndërkohë, me aktin nr. 133/1 prot., datë 13.1.2025, vërej se është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punësimit për punonjësen *Ergesa Lika*, me detyrë “*Specialist i Burimeve Njerëzore*”.

Në **pikën 4**, të vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga Kryetari i Bashkisë Kurbin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit për 8 punonjës në pozicionet e punës të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese të nxjerra në kundërshtim me ligjin.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të punës, në Bashkinë Kurbin konstatoj se për punonjësit më poshtë janë ndërprerë marrëdhëniet e punësimit me institucionin. Konkretisht:

- Punonjësi Petrit Xheladini, në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Mjedisit, është liruar nga detyra me aktin nr.5868/1 prot., datë 25.11.2024;
- Punonjësi Benard Palaj, në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, është liruar nga detyra me aktin nr. 387, prot., datë 27.1.2025.

Njëkohësisht, vërej se, për pozicionet e punës që i përkasin kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese (*shpalljet e vendeve vakante nr. 3150 prot., nr. 3151 prot., datë 8.7.2025, nr. 3189 prot., datë 10.7.2025, nr. 3295 prot., dhe nr. 3296 prot., datë 17.7.2025*), janë shpallur gjithsej 7 procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve vakante si më poshtë:

- “Drejtor”, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit;
- “Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të të Ardhurave dhe Veprimeve me Financën”, në Drejtorinë e Planifikimit të të Ardhurave;
- “Përgjegjës Sektori Mjek Veteriner”, në Drejtorinë e Mjedisit;
- “Drejtor”, në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve Publike;
- “Përgjegjës”, në Sektorin e Planifikimi të Territorit;
- “Drejtor”, në Drejtorinë e Shërbimeve Publike;
- “Përgjegjës Sektori i Ndhmës Ekonomike”, në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike dhe Kujdesit Social.

Për nëpunësen Pashke Marku, për të cilën, Komisioneri ka kërkuar të kthehet në pozicionin e mëparshëm, “*Specialist i Emergjencave Civile*, në Drejtorinë e Shkencave Publike ose në një pozicion tjetër të barazvlefshëm me të, vërej se se me Urdhrin nr. 137, datë 17.7.2025, të Kryetarit të Bashkisë, kjo nëpunëse është emëruar në pozicionin “*Specialiste për Statistikat*”, në Drejtorinë e Financës.

Në **pikën 5** të vendimit paralajmërues, Komisioneri i ka kërkuar njësisë përgjegjëse dhe subjekteve të ngarkuara me detyra të administrimit të shërbimit civil, të rregullojë situatën në lidhje me institutin e konfirmimit dhe deklarimit pas periudhës së provës për 15 punonjës duke ndjekur orientimet e dhëna në këtë vendim.

Konstatohet se, njësia përgjegjëse (njësia e burimeve njerëzore të institucionit), në zbatim të pikës 13, të kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, ka ndërmarrë të gjitha veprimet administrative të nevojshme në përfundim të periudhës së provës për secilin nëpunës civil.

Konkretisht, kjo njësi, pas anulimit të akteve fillestare të konfirmimit dhe njohjes me vendimet e konfirmimit të nxjerra nga eprorët direkt të nëpunësve, ka miratuar aktet përkatëse të deklarimit të statusit të evidentuara më poshtë, në përputhje me parashikimet ligjore:

- Me aktin nr. 183/3 prot., datë 17.1.2025, Davidja Jushi konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin, “*Specialist Jurist*”, në Drejtorinë e Mjedisit;
- Me aktin nr. 191/3 prot., datë 17.1.2025, Lindita Trokthi konfirmohet nëpunës civil në pozicionin, “*Specialist Regjistri*”, në Drejtorinë Taksave dhe Tarifave Vendore;
- Me aktin nr. 182/3 prot., datë 17.1.2025, Lorenc Ndoj konfirmohet nëpunës civil në pozicionin, “*Specialist i Bujqësisë*”, në Drejtorinë e Mjedisit;
- Me aktin nr. 181/3 prot., datë 17.1.2025, Redon Lepuri konfirmohet nëpunës civil në pozicionin, “*Specialist i Mjedisit dhe Turizmit*”, në Drejtorinë e Mjedisit;
- Me aktin nr. 186/3 prot., datë 17.1.2025, Sidorela Tanushi konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin, “*Specialist i Kujdesit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Shëndetësinë*”, në Drejtorinë e Ndhmës Ekonomike & Kujdesit Social;

- Me aktin nr. 3366/1 prot., datë 21.7.2025, Arbjona Prenga konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin, “*Specialist i Kujdesit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Shëndetësinë*”, në Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike & Kujdesit Social;
- Me aktin nr. 184/3 prot., datë 17.1.2025, Zj. Rovena Piroli konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin, “*Specialist i Kontabilitetit*”, në Drejtorinë e Financës;
- Me aktin nr. 185/3 prot., datë 17.1.2025, Ariola Kaçorri konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin, “*Specialist i Integritit me BE*”, në Drejtorinë për Koordinimin e Integritit Evropian dhe Ndihmës së Huaj;
- Me aktin nr. 3367/1 prot., datë 21.7.2025, Elbarina Gjinaj konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin, “*Specialiste e Buxhetit*”, në Drejtorinë e Financës;
- Me aktin nr. 187/3 prot., datë 17.1.2025, Altin Marashi konfirmohet nëpunës civil në pozicionin, “*Inxhinier Ndërtimi*”, në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Kontrollit të Territorit;
- Me aktin nr. 188/3 prot., datë 17.1.2025, Kristina Gjoka konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin, “*Inxhinier Hidroteknik*”, në Drejtorinë e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Kontrollit të Territorit;
- Me aktin nr. 192/3 prot., datë 17.1.2025, Mirela Kola konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin “*Specialiste e Burimeve Njerëzore*”, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore;
- Me aktin nr. 189/3 prot., datë 17.1.2025, Françeska Marku konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin, “*Specialiste Juriste*”, në Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve Publike;
- Me aktin nr. 193/3 prot., datë 17.1.2025, Vjola Gjinaj konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin, “*Administratore*”, në Drejtorinë e Ndihmës Ekonomike dhe Kujdesit Social;
- Me aktin nr. 3368/1 prot., datë 21.7.2025, Pashke Marku konfirmohet nëpunëse civile në pozicionin “*Specialist për Statistikat*”, në Drejtorinë e Financës.

Në **pikën 6** të Vendimit parlajmëruës, sa i takon parregullsive të konstatuara gjatë zhvillimit të procesit të konkurrimit për pozicionin “*Drejtor*” në Drejtorinë e Financës, Komisioneri ka kërkuar rregullimin e ligjshmërisë nga ana e njësisë përgjegjëse, duke anuluar procedurën e ngritjes në detyrë dhe duke e rikthyer nëpunësen në pozicionin e mëparshëm ose në një pozicion të barasvlershëm me të, për shkak sekandidati fitues punonjësja R. Kola, ka qenë nëpunëse civile brenda institucionit, në pozicionin “*Specialist i Zyrës së Financës*”, sipas aktit nr. 7, datë 7.5.2015, pozicion të cilin e ka mbajtur deri në momentin e emërimit në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë Financës.

Nga aktet e administruara në subjekt nga grupi i punës i ngritur me urdhrin nr. 65, datë 2.7.2025, të Komisionerit, konstatoj se, procedura e ngritjes në detyrë të punonjësës Rake Kola në pozicionin “*Drejtor i Financës*” është realizuar sipas përcaktimeve të nenit 26, pika b, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Ky përfundim arrihet pas shqyrtimit të hollësishëm të dokumentacionit të plotë të procedurës së konkurrimit, nga ku vërej se me aktin nr. 2919/1 prot., datë 11.8.2016, institucioni i Bashkisë Kurbin ka shpallur Njoftim për vend të lirë pune “*Për lëvizjen*”

paralele dhe ngritjen në detyrë në nivelin e ulët drejtues për plotësimin e vendit të lirë në punë të Administratës e Bashkisë Kurbin”, në pozicionin “Përgjegjës Sektori të Kontabilitetit”.

Më tej, me aktin nr. 3010 prot., datë 22.9.2016, është bërë njoftimi për Listën e Fituesve për këtë pozicion, ku fituese ka dalë znj. Rake Kola. Në vijim, me aktin nr. 3010/3, datë 19.9.2017, është bërë emërimi i saj si nëpunëse civile në pozicionin në fjalë, të cilin e ka mbajtur deri në momentin e konkurrimit për pozicionin “Drejtor” në Drejtorinë e Financës.

Mirëpo, konstatoj se këto dokumente nuk i janë vënë në dispozicion grupit të punës gjatë mbikëqyrjes në subjekt dhe nuk janë paraqitur as në observacionet e institucionit pas marrjes së projektraportit të mbikëqyrjes.

Në *pikën 7* të Vendimit paralajmërues, Komisioneri ka kërkuar nga ana e njësisë së Burimeve Njerëzore për të marrë masa në lidhje me mangësitë e konstatuara nga verifikimi i akteve të depozituara në dosjen e personelit, të evidentuara në Raportin e Mbikëqyrjes.

Nga verifikimi i dosjeve përkatëse, vërej se nëpunësit *Armandela Bardhi, Vinçenca Rica, Elbarina Gjinaj dhe Lindita Trokthi* kanë dorëzuar diplomat e noterizuara pranë Njësisë Përgjegjëse, të cilat janë administruar nga grupi i punës.

Ndërsa nëpunëset *Dorina Dehari dhe Esmeralda Kuka* janë larguar për shkak të dorëheqjes, me aktet e mëposhtme:

- Akti nr. 4218/1 prot., datë 09.9.2024, për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare me institucionin për nëpunësen *Dorina Dehari (akti i dorëheqjes nr.4218, dt. 09.09.2024).*
- Akti nr. 2327/1 prot., datë 20.5.2024, për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare me institucionin për nëpunësen *Esmeralda Kuka (akti i dorëheqjes nr.2327, dt. 20.5.2024).*

Nisur nga sa më sipër, *vlerësoj se*, nga ana e institucionit, Bashkia Kurbin, janë kryer veprimet administrative të nevojshme për zbatimin e detyrave të lëna në Vendimin Paralajmërues Nr.42, datë 16.7.2024, të Komisionerit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 11, pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe Rregulloren, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015 (e ndryshuar), të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 42, datë 16.7.2024, të Komisionerit, *“Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Kurbin dhe paralajmërimin e institucionit për rregullimin e ligjshmërisë, me qëllim përmirësimin e situatës”*.
2. Konstatimin e rregullimit të ligjshmërisë nga ana e institucionit Bashkia Kurbin duke zbatuar detyrat e lëna në dispozitivin e Vendimit nr.42, datë 16.7.2024.
3. Për këtë vendim të njoftohet Kryetari i Bashkisë Kurbin.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



